

PAOLA SHQYPI

**VËZHGIME GJUHËSORE MBI REVISTËN “KUMTARI ARSIMUER”
TË VITIT 1921**

Me Shpalljen e Pavarësisë më 28 Nëntor 1912 fillon një etapë e re edhe për gjuhën shqipe. Periudha e zhvillimit të gjuhës së shkruar shqipe në dhjetë vjetët e parë pas pavarësisë është studiuar e vlerësuar në mënyrë deri diku të përgjithshme. Por për të arritur në një vlerësim më të saktë të gjendjes së lëvrimit të gjuhës shqipe dhe të stabilizimit të normës letrare në atë periudhë, është e nevojshme të ndërmerren hulumtime më të ngushta. Prej tyre mund të krijohet pastaj një pamje më e plotë e arritjeve dhe problemeve të shqipes së shkruar në atë periudhë. Për këtë qëllim zgjodhëm të hulumtojmë drejtshkrimin e zbatuar dhe problemet drejtshkrimore në revistën “Kumtari arsimuer” që doli në katër numra në vitin 1921. Revista arrin në 114 faqe shtypi gjithsej: nr. 1 - 27 faqe, nr. 2 - 39 faqe, nr. 3-4 - 48 faqe.

Dalja e kësaj reviste lidhet me organizimin e shtetit shqiptar pas Kongresit të Lushnjës dhe me detyrat që shtroi qeveria shqiptare e kohës në fushën e arsimit. Sapo kishte përfunduar Lufta e Parë Botërore dhe Konferenca e Paqes në Paris. Shqipëria kishte shpëtuar nga copëtimi i mëtejshëm. Pas përfundimit me sukses të Luftës së Vlorës (2 gusht 1920) më në fund trojet shqiptare në kufijtë e caktuar nga Konferenca e Londrës e vitit 1913 ishin bashkuar me qeverinë e Tiranës. Në dhjetor 1920 Shqipëria u bë anëtare e Lidhjes së Kombeve. Një nga përparësitë e shtetit shqiptar ishte organizimi i arsimit kombëtar, pasi gjatë Luftës së Parë Botërore arsimi ishte ndarë sipas zonave të pushtimit (austro-hungareze, italiane, franceze). Më 15 gusht 1920 u mbledh në Lushnjë Kongresi Arsimor Kombëtar, ku u përcaktua dhe sistemi arsimor që do të ngrihej. U ngrit dhe Këshilli i Epër Arsimuer, i cili botoi gjatë vitit 1921 organin e vet Kumtari arsimuer”. Në numrin e parë të “Kumtarit” (mars 1921), parashtrohet dhe programa (siç përdorej atëherë) e tij, si më poshtë:

“Kumtari arsimuer” qi po del sot në dritë ka për programë e për qëllim të botojë shkrime e të rrahë bisedime mbi çështje letrare, gjuhësije e pedagogjike përgjithënisht, të shpallë punët më të rëndësishme të Këshillit t’Epër Arsimuer, si kritika mbi libra shkollorë, rregullore, programa, etj. e përgjithënisht të mbajë të lajmuem jo vetëm çdo arsimtar, por edhe çdo njeri qi interesohet për punët shkollorë mbi punët e vendimet më me rëndësi qi i përkasin arsimit botuer.

Dihet se sistemi arsimor i Shqipërisë në fillim të viteve ’20 të shekullit të kaluar kishte mungesa të mëdha jo vetëm në infrastrukturën mësimore, por edhe në kuadrin e nevojshëm mësimdhënës dhe drejtues. Mungonin jo vetëm shkolla, mjete, mësues dhe investime, por edhe metodika e mësimdhënies dhe literatura pedagogjike ishte shumë e cunguar. Duke qenë në këto kushte, doli e nevojshme

hartimi dhe botimi i një reviste e cila shërbente dhe si orientuese por edhe si udhëzuese për mësimin. Siç thuhet dhe në “programën” e cituar më lart, kjo revistë kishte për qëllim të botojë shkrime dhe të ngrejë bisedime mbi çështje letrare, gjuhësie e pedagogjike.

Kumtari botoi materiale të rëndësishme zyrtare e informative, siç janë vendimet e Kongresit Arsimor të Lushnjës, njoftime bibliografike për tekstet shkollore, materiale metodike për zhvillimin e lëndëve të ndryshme, materiale didaktike mbi organizimin e procesit mësimor, për figurën dhe detyrat e mësuesit, të drejtorit të shkollës etj. Në të përfshihen kritika mbi librat shkollorë, rregullore, programe dhe ajo mundohet të mbajë në dijeni çdo arsimtar e sigurisht dhe çdo njeri që interesohet për çështje shkollore dhe për vendimet më të rëndësishme të cilat i përkasin arsimit.

1. Qëllimi i studimit dhe metoda e punës.

Vëzhgime gjuhësore mbi revistën “Kumtari Arsimuer” të vitit 1921, ka të bëjë me krahasimin e drejtshkrimit të zbatuar në atë revistë me normën e sotme drejtshkrimore. Në këtë studim janë parë format drejtshkrimore të asaj periudhe, cilat forma ishin mbizotëruese dhe cilat prej tyre kishin lëkundje. Në cilat rregulla gjejmë forma të njëjta dhe në cilat prej tyre ka paraqitje të ndryshme të tyre nga drejtshkrimi i sotëm ose luhatje të brendshme dhe cilat mund të jenë arsytet për këtë.

“Kumtari”, si organ i Këshillit të Epër Arsimuer, d.m.th. i përgatitur nga njerëzit më të kulturuar të arsimit kombëtar, ka pasur edhe një përkujdesje gjuhësore të posaçme, pasi i drejtohej shkollës dhe do të shërbente si model dhe si udhërrëfyes edhe për gjuhën. Lënda e “Kumtarit” është shkruar në një gegërishte të mesme, ashtu siç pati vendosur Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918). Rregullat gjuhësore që caktoi ajo Komisi gjetën zbatim në përgjithësi edhe te “Kumtari”, por aty vërehen edhe luhatje. Lënda e “Kumtarit” na jep mundësi të bëjmë një përshkrim të zbatimit të normës drejtshkrimore në vitin 1921. Për këtë qëllim bëmë një vjelje të plotë e sistematike të gjithë lëndës së tij dhe e klasifikuam sipas çështjeve drejtshkrimore që përmbajnë kapitujt e veprës “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” (1973).

Gjithnjë kemi mbajtur para sysh se gjuha e “Kumtarit” ka si bazë dialektore gegërishten jugore (sidomos dialektin e Elbasanit), ndryshe nga shqipja e sotme standarde që mbështetet në toskërishten veriore dhe në traditën letrare toske (sidomos në fonetikë e në morfologji). Kjo na ka dhënë mundësi të vërejmë si problemet drejtshkrimore që kanë të bëjnë me bazën dialektore (p.sh. shkrimi i zanoreve hundore, i dyzanorëve, i grupeve të bashkëtingëlloreve etj.), ashtu dhe ato që kanë të bëjnë me shqipen në përgjithësi (p.sh. shkrimi i zanores *ë* të patheksuar në pozicione të ndryshme, i bashkëtingëlloreve *rr*, *h*, *j* etj.). Materialin e vjelë dhe të analizuar e kemi krahasuar sistematikisht me rregullat e sotme të drejtshkrimit, pra kemi ndjekur metodën e krahasimit në një hapësirë kohore prej gjysmë shekulli (1921 “Kumtari” – 1973 “Drejtshkrimi”).

2. Një panoramë e periudhës historiko-gjuhësore gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore dhe në fillim të viteve ‘20

Gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore Shqipëria u gjend e pushtuar nga trupat e fuqive ndërluftuese: Austro-Hungaria, Italia, Franca. Pjesa më e madhe e territorit shqiptar ishte nën administrimin e Austro-Hungarisë, që kishte caktuar Shkodrën si qendër administrative. Në dhjetor 1916, me nismën e një grupi intelektualësh shqiptarë dhe me mbështetjen e konsullit të përgjithshëm të Austro-Hungarisë e të komandës ushtarake austriake në Shkodër, u ngrit në Shkodër pranë Drejtorisë së Arsimit një komision gjuhëtarësh e letrarësh, që u quajt Komisia Letrare Shqipe. Në të morën pjesë atdhetarë e studiues të shquar si Luigj Gurakuqi, Gjergj Fishta, Hil Mosi, Sotir Peci, Mati Logoreci, Gjergj Pekmezi (që u caktua kryetar), Aleksandër Xhuvani, Ndre Mjeda, Ambroz Marlaskaj, Ndue Paluca, Hafiz Ali Korça, Vinçenc Prenushi, Luigj Naraçi, Josif Haxhimima. U thirrën për të ndihmuar si specialistë albanologët austriakë Maksimilian Lamberg dhe Rajko Nahtigal.

Detyra themelore që i vuri vetes Komisia Letrare ishte organizimi i arsimit dhe zhvillimi i mëtejshëm i tij, lëvrimi i gjuhës letrare shqipe dhe zhvillimi i letërsisë shqiptare, njësimi i drejtshkrimit të shqipes dhe pasurimi i saj, krijimi i termave dhe i fjalëve të reja, botimi i librave dhe i teksteve shkollore, ngritja dhe organizimi i bibliotekave etj. ajo punoi në frymën e ideve themelore të Rilindjes Kombëtare, duke u nisur nga qëllimi që të ndihmonte për krijimin e një gjuhe letrare të përbashkët duke i afruar sa më shumë të dy variantet letrarë të shqipes. Kjo Komisi e vlerësoi variantin letrar të mesëm të mbështetur mbi të folmet e gegërishtes jugore (kryesisht Elbasani) si urë në mes të toskërishtes e të gegërishtes dhe dha një ndihmesë të rëndësishme për të përpunuar rregullat drejtshkrimore, të cilat e çuan më tej njësimin e shqipes së shkruar. Në janar të vitit 1917 Komisia miratoi për herë të parë kodin drejtshkrimor “Parime e rregulla mbi ortografinë e gjuhës së shkruar”, i cili u botua si broshurë e veçantë dhe më pas dhe në shtypin e kohës. Vendimet e Komissisë për drejtshkrimin qenë një hap i madh përpara në rrugën e njësimin të tij. Në fushën e terminologjisë ajo caktoi rreth 500 terma për administratën shtetërore e për gjyqet.

Komisia kreu edhe detyrat e një këshilli shkencor-metodik për tekstet shkollore dhe për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme të arsimit botor e të kulturës gjuhësore. Ajo botoi një numër të organit të saj me titull “Laimet e Komissisë letrare shqipe në Shkodër” (1918), në të cilin është paraqitur në mënyrë të përmbledhur veprimtaria e saj gjatë viteve 1916–1917.

Ndër vendimet e para dhe shumë të rëndësishme në mbledhjet e Komissisë ishin: vendosja e një drejtshkrimi që të synonte afrimin e gegërishtes me toskërishten, duke marrë si bazë një fazë të gjuhës kur këto kishin më shumë tipare të përbashkëta fonetike e gramatikore. Kështu Komisia vendosi që të ruheshin të plotë grupet e zanoreve **ie, ue, ye**, grupet **mb, nd, ngj**, të cilat në gegërishte ishin asimiluar, por në toskërishte shqiptoheshin qartë. Këto grupe ruhen edhe te autorët e vjetër gegë, Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani. Komisia u

kufizoi shënimin e kuantitetit të zanoreve dhe përdorimin e shenjës grafike të hundorësisë “” mbi zanore. Gjithashtu ruajtja e ë-së së patheksuar në trup të fjalës në shumë pozicione, si dhe fund të saj.

Drejtshkrimi i zanoreve

Zanorja A e theksuar

Meqenëse lënda e kumtarit është në gegërishte, janë shkruar me **a** të gjitha fjalët të cilat kjo zanore e theksuar ndiqet ose është ndjekur historikisht nga një bashkëtingëllore hundore. Me **a** shkruhen edhe të gjitha fjalët e prejardhura ose të përbëra, të formuara prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit: p.sh.: *i âmbël* (përdoret vetëm 1 herë), *i argjândëtë* (vetëm 1 herë), *asgjâ* (3 herë), *âsht* (mbi 150 herë), *bâkeqës* (vetëm 1 herë), *me bâmë* (2 herë), me i bâmë (1 herë), *bân* (7 herë), *bâni* (7 herë), *bâni- e* (2 herë), *t' i bâni* (vetëm 1 herë), *u bânji* (vetëm 1 herë), *do të bânte* (vetëm 1 herë), *ka bâmun* (1 herë), *dâm* (3 herë), *i dâmshëm* (vetëm 1 herë), *e dâmshme* (vetëm 1 herë), *dëldhâmbës* (vetëm 1 herë), *domethâne* (vetëm 1 herë), *domethânë* (vetëm 1 herë), *ka dhânë* (2 herë), me i dhânë (4 herë), *tue i dhânë* (1 herë), *çâshtje* (8 herë), *çâshtjen* (vetëm 1 herë), *çâshtjesh* (vetëm 1 herë), *çâshtjet* (8 herë), *çartakândas* (vetëm 1 herë), *fargjâje* (vetëm 1 herë), *frângash* (vetëm 1 herë), *frângu* (vetëm 1 herë), *frângjisht* (vetëm 1 herë), *frângjishte* (2 herë), *gojdhâna* (vetëm 1 herë), *gjâ* (30 herë), *gjâna* (4 herë), *e gjânë* (vetëm 1 herë), të gjânë (vetëm 1 herë), *gjânsinën* (vetëm 1 herë), *gjâsende* (vetëm 1 herë), *gjâsendet* (vetëm 1 herë), *gjâsent* (vetëm 1 herë), *kâmbë* (9 herë), *kâmbët* (4 herë), *kâmbës* (përdoret herë), *kângët* (vetëm 1 herë), *kângëtimi* (vetëm 1 herë), *kryegjâ-ja* (vetëm 1 herë), *kurgjâ* (vetëm 1 herë), *lânda* (3 herë), *mâ* (280 herë), *marrëdhânje* (vetëm 1 herë), *marrëdhânjet* (vetëm 1 herë), *mkâmbin* (vetëm 1 herë), *nânën* (vetëm 1 herë), *e njâjë* (vetëm 1 herë), *njâna* (vetëm 1 herë), *njânët* (vetëm herë), *të ngrânet* (vetëm 1 herë), *nxânës* (22 herë), *nxânësve* (38 herë), *nxânsit* (51 herë), *qândër* (përdoret 5 herë), *qândra* (vetëm 1 herë), *rândësi* (8 herë), *e rândsishme* (vetëm 1 herë), *rânjë* (2 herë), *të rândë* (2 herë), *rândësin* (2 herë), *rrâjë-a* (2 herë), *u rândohet* (vetëm 1 herë) etj.

Në tekst gjejmë të përdorur një herë të vetme dhe formën: *do të bënë*.

Siç dihet, në shqipen e sotme standarde me bazë fonetike sipas toskërishtes, fjalët e mësipërme shkruhen me **ë**, d.m.th. *bëj*, *çështje*, *dëm*, *dëmtoj*, *(kam) dhënë*, *hënë*, *këmbë* etj. Janë pranuar si përjashtime disa fjalë që janë ngulitur në gjuhën standarde në formën e gegërishtes, si p.sh. *i mangët*, *ranishte*, *shmang*, *zanë*, *zanore*.

Zanorja E e theksuar (§ 1)

Meqenëse shkrimet e kumtarit janë në dialektin gegë (gegërishtja jugore ose dialekti i Elbasanit), zbatohet në përgjithësi rregulla e sotme e drejtshkrimit, sipas së cilës:

“Shkruhen me **e** (dhe jo me **ë**) fjalët ku kjo zanore është e theksuar dhe ndiqet ose ka qenë ndjekur në të kaluarën nga një bashkëtingëllore hundore (**m**, **n**, **nj**). Me **e** shkruhen gjithashtu fjalët e prejardhura ose të përbëra të formuara prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit.” (§ 1): p.sh.: *gjendje* (në tekst përdoret 1 herë), *gjendjen* (2 herë), *mendje* (2 herë), *mendjes* (6 herë), *mendjen* (4 herë), *shembull*

Vëzhgime gjuhësore mbi revistën “Kumtari arsimuer” të vitit 1921

(vetëm 1 herë), *shembuj* (9 herë), *shembujsh* (vetëm 1 herë), *shembujt* (vetëm 1 herë), *shembulli* (përdoret 2 herë), *shembujve* (përdoret 2 herë), *zemre* (vetëm 1 herë), *zemër* (6 herë), *zembrës* (3 herë), *zembra* (2 herë), *zembër* (7 herë).

Por në Kumtar gjejmë edhe raste kur fjalët e mësipërme ose fjalë të këtij tipi janë shkruar me **ë**, sipas shqiptimit dhe traditës së shkrimit të një pjese të madhe të toskërishtes, p.sh.: *gjëndet* (vetëm 1 herë), *gjëndjen* (vetëm 1 herë), *gjenden* (2 herë), *mëndje* (vetëm 1 herë), *mëndjevet* (vetëm 1 herë), *shëmbëllat* (2 herë), *shëmbëllavet* (vetëm 1 herë), *zëmërimë* (vetëm 1 herë), *zëmërimet* (vetëm 1 herë).

Dalin dy herë të vetme brenda të njëjtit paragraf fjalët: *arësënjesi*, *arësënjesvet*; këto fjalë nuk i kemi gjetur të shkruara në formën *arësenjës*; mesa duket forma me **ë** është një gabim shtypi ose një përdorim individual i rastit.

Nga statistika e mësipërme del se mbizotërojnë format e shkruara me zanoren **-e-** në vend të zanores **-ë-**, në fjalët ku kjo zanore ndiqet nga një bashkëtingëllore hundore (**m, n, nj**). Vihet re një lëkundje në përdorimin e zanores **-e-**, herë gjenden forma me **ë** dhe herë zanorja **e** shfaqet bindshëm duke u bërë formë zotëruese. Kjo lëkundje në përdorimin e zanores **e** mund të jetë dhe një veçori e një shkruesi të një pjese të tekstit, i cili ka bartur me vete dhe veçoritë dialektore të tij.

Zanorja E e patheksuar

“Drejtskrimi i gjuhës shqipe” përcakton se tek emrat femërorë, të cilët kanë një **-e** fundore të patheksuar në trajtën e pashquar të njëjësit, në emëroren e shquar bie **-e-** ja, ndërsa në rasat e tjera ajo shkruhet.” (§ 2): p.sh.: Kjo rregull drejtskrimore gjen zbatim në revistë. Kemi gjetur shembujt e mposhtëm: *çâshtja* (përdoret vetëm 1 herë), *familja* (përdoret 2 herë), *lulja* (përdoret vetëm 1 herë). Nuk dalin në asnjë rast forma të tilla si: *çâshtjeja*, *familjeja*, *luleja*, *rrokjeja* etj.

Zanorja Ë e patheksuar:

ë- ja paratheksore (§ 5) **ë-ja** paratheksore shkruhet në këto raste p.sh.:

a) Janë shkruar me **ë** paratheksore një varg fjalësh të parme, fjalë ku kjo zanore i takon rrokjes së parë, si edhe fjalët e formuara prej të dy grupeve të mësipërme, p.sh.: *dobësohet* (përdoret vetëm 1 herë), *drejtësie* (vetëm 1 herë), *dëlhirdhambës* (vetëm 1 herë), *të gëzohen* (vetëm 1 herë), *këte* (2 herë), *këtej* (vetëm 1 herë), *këti* (5 herë), *të këti* (vetëm 1 herë), *këtij* (3 herë), *u- ndërruem* (vetëm 1 herë), *të ndërruem* (vetëm 1 herë), *të ndërrueshme* (vetëm 1 herë), *tue ndërruem* (vetëm 1 herë), *të ndërroni* (vetëm 1 herë), *përfaqësuem* (3 herë), *pakënaqësive* (vetëm 1 herë), *tregëtin* (vetëm 1 herë), *shëndosha* (vetëm 1 herë), *shpëtojnë* (vetëm 1 herë), *vullëndet* (4 herë), *zvetënohet* (vetëm 1 herë)

Vërehen luhaje në shkrimin e emrit *arsim* – *arësim* dhe të fjalëve të prejardhura prej tyre. Kështu forma *arsim* (sipas drejtskrimit të sotëm) është përdorur 92 herë, ndërsa *arësim* 18 herë; forma *arsimuer/arsimor* është përdorur 42 herë, ndërsa *arësimuer* 2 herë; forma *arsimtar* 5 herë, ndërsa *arësimtar* asnjë herë.

Po kështu bie në sy se fjala *tregtar* (del vetëm 1 herë) është shkruar pa -ë-, d.m.th. sipas drejtshkrimit të sotshëm, ndërsa *tregëti* (del vetëm dy herë) është shkruar me -ë-, ndërsa sot shkruhet *tregti*.

Siç dihet, në gegërishten e folur zanozja *ë* e patheksuar në këtë pozicion, është reduktuar shumë, shpesh deri në shkallën zero, p.sh. *gëzohem*, *dobsohet drejtsi* ... etj. Te Kumtari në fjalët e këtij tipi është ndjekur mënyra e shkrimit dhe e shqiptimit e toskërishtes letrare të kohës, në pajtim edhe me "Rregullat" e Komisionit Letrar të Shkodrës. Pra, drejtshkrimi i Kumtarit është në pajtim me rregullën e sotme të drejtshkrimit të shqipes (§ 5 a). Por sipas drejtshkrimit të sotëm fjalët *arsim* dhe *tregti* si dhe rrjedhojat e tyre shkruhen pa -ë-, pra jo arësim, tregëti etj., siç dalin në një numër rastesh te "Kumtari".

b) në fjalë të prejardhura, të formuara nga një temë më -ë me anë prapashtesash që nisin me bashkëtingëllore, dhe në fjalë të përbëra e të përngjitura që kanë si pjesë të parë një temë të tillë më -ë, të ndjekur nga një temë që nis me bashkëtingëllore: *drejtësia* (përdoret vetëm 1 herë), *gjuhësia* (vetëm 1 herë), *hollësia* (vetëm 1 herë), *hollësi* (vetëm 1 herë), por ky emër gjendet dhe një herë në trajtën *hollësi*

lehtësisht (2 herë), *lehtësia* (vetëm 1 herë), *i lehtësojnë* (1 herë), *mirësohet* (1 herë), *përgjithësisht* (3 herë), gjendet dhe një herë të vetme *përgjithnisht*, *përmirësimin* (1 herë), *përmirësohet* (1 herë), *përpjesëtimin* (1 herë), *plotësisht* (2 herë), *përplotësojnë* (2 herë), *punëtorët* (2 herë), *ulehtësuem* (2 herë).

Po kështu shkruhen me *ë* (si zanore mbështetëse) edhe fjalët e prejardhura, që, megjithëse formohen nga tema më bashkëtingëllore, kanë një strukturë fonetiko-fjalëformuese të ngjashme me atë të fjalëve të mësipërme: *dobësia* (1 herë), *të dobësohet* (1 herë), *hapësirë* (1 herë), *kombëtar* (4 herë), *kombëtare* (7 herë), *madhështia* (1 herë), *zotësi* (2 herë), *të vargëzueme* (herë).

Nga shembujt e mësipërm të pikave b dhe c shihet se drejtshkrimi i Kumtarit është në pajtim me rregullën e sotme të drejtshkrimit. Për këtë rregull ka pasur dhe ka diskutime. Disa mendojnë se në pajtim me reduktimin e -ë-së në shqiptim të pakësohen rastet e shkrimit të saj, disa të tjerë janë të mendimit se rregulla mbështetet edhe në parimin morfologjik, prandaj nuk duhet të ndryshohet.

ç) në fjalët e prejardhura, të formuara prej temash më -ër, -ërr, -ël, -ës, -ëz, me anë prapashtesash që fillojnë me zanore: *mjeshtëri* (përdoret 6 herë), *e mjeshtëris* (2 herë), *njerëzis* (3 herë).

Në përgjithësi shkrimi i zanores *ë* të patheksuar te Kumtari nuk ka dallime thelbësore nga rregullat e sotme të drejtshkrimit për këtë zanore.

Disa fjalë që sipas drejtshkrimit të sotëm shkruhen pa -ë- në trup të tyre, në Kumtar ruhet forma e vjetër shkrimore që kanë pasur ato, p.sh.: *gjithënji* (përdoret 2 herë), *gjithnji* (7 herë), *lutënia* (2 herë, asnjëherë pa -ë-), sot kjo fjalë përdoret në kuptimin e emrit *lutje-lutja*, *të shkurtëna* (përdoret 1 herë, asnjëherë pa -ë-), *tregëti* (1 herë, asnjëherë pa -ë-), *tregëtin* (1 herë, asnjëherë pa -ë-).

Përveç ndajfoljes *gjithnji*; *gjithënji* në të cilën kemi luhatje me denduri jo të shpeshtë, madje mund të thuhet se mbizotëron forma e shqipes së sotme standarde

gjithnjë, tregon se kjo ndajfolje ka filluar të ngulitet në formën e sotme që në ato vite.

ë-ja pastheksore

Janë shkruar me **-ë-** pastheksore

a) emrat femërorë më **-ëz**, dhe emrat e mbiemrat mashkullorë më **-ës**, **-ësh**, si dhe femërorët përkatës në të gjitha trajtat e lakimit të tyre (“Drejtshkrimi” § 6), p.sh.: *lidhëzë*-a (1 herë), *ligjë-bamësi* (1 herë), *ligjëbamësit* (1 herë), *nxânësit* (8 herë),

b) mbiemrat me **-ët** në të gjithë trajtat e lakimit të tyre: *e dobët* (përdoret vetëm 1 herë), *të dobët* (vetëm 1 herë), *t’ errët* (2 herë), *të kthjellët* (2 herë), *e kthjellët* (vetëm 1 herë), *të përbashkët* (5 herë), *e përbashkët* (4 herë), *i përbashkët* (3 herë), *t’ulët* (2 herë).

Mbiemrat e mësipërm nuk dalin asnjëherë në formën më **-të** (*i dobtë*, *i ultë* etj.).

ë-ja pastheksore (§ 6)

a) Nuk është shkruar **-ë-ja** pastheksore tek emrat dhe mbiemrat më **-ël**, **-ër**, **-ërr** dhe tek mbiemrat mashkullorë më **-izëm**, **-azëm** gjatë lakimit, kur pas këtyre fundoreve vjen një zanore: *numri* (përdoret 19 herë), *e numrit* (5 herë), *i numrit* (2 herë), *numrit* (2 herë), *së numrit* (2 herë), *numrin* (4 herë), *vegla* (11 herë), *të veglave* (2 herë), *veglat* (5 herë), *vepër* 6 - *vepra* 6 (12 herë), *veprat* (2 herë), *të veprave* (2 herë), *i vogli* (1 herë), *zemra* (1 herë).

Nuk kemi gjetur në Kumtar raste kur kjo zanore të ruhet në shkrim (d.m.th. forma si *numëri*, *vegëla*, *zëmëra* etj.), pra mund të themi se rregulla e sotme e drejtshkrimit ka qenë e konsoliduar që në fillim të viteve ‘20 të shekullit të kaluar d.m.th. në kohën kur botohej Kumtari.

b) Mbiemrat me prapashtesën **-shëm** gjatë lakimit, kur pas kësaj prapashtese vjen një zanore ose një **j**, dalin të shkruar përgjithësisht me **-ë-**; vetëm te fjala ***e përgjithshme***, siç ***do të*** vërehet më poshtë, mbizotërojnë rastet me **-ë-**: *të duhishëm* (përdoret vetëm 1 herë), *të dukëshme* (1 herë), *të frytëshme* (1 herë), *gjithanëshëm* (2 herë), *mbrendëshme* (2 herë), *i nevojshëm* (2 herë), *e përgjithëshme* (1 herë, por e gjejmë në formën *e përgjithshme* 3 herë), *të përgjithëshme* (2 herë, por e gjejmë në formën *të përgjithshme* 5 herë), *shumanëshëm* (vetëm 1 herë), *të vullnetëshme* (vetëm 1 herë).

mbiemrat me prapashtesën **-ëm** në kushtet e mësipërme dalin të shkruar me **-ë-** përveç mbiemrit *e sotme*, i cili përkon me formën e drejtshkrimit të sotëm: *e mesëm* (përdoret 1 herë), *të mesëm* (2 herë), *i përjashtëm* (4 herë), *e sotme* (3 herë), *i përjashtëm* (4 herë), *i vetëm* (2 herë).

Me sa duket, në atë kohë **-ë-ja** e patheksuar ruhej ende në shqiptim në njëfarë mase dhe kjo gjendje pasqyrohet edhe në shkrimin e saj në format e ndryshme të mbiemrave ma prapashtesat e mësipërme.

c) Në shumë raste nuk shkruhet **-ë-** paratheksore para prapashtesave **-shëm** dhe **-të** në të gjitha trajtat e mbiemrave të formuar prej tyre: *i natyrshëm* (përdoret vetëm 1 herë), *të përbotshëm* (vetëm 1 herë), *të pestën* (vetëm 1 herë), *e pestë* (vetëm 1 herë),

Por në një varg rastesh e gjejmë të shkruar, p.sh.: *të frytëshme* (përdoret vetëm 1 herë), *gjithanëshëm* (2 herë), *mbrendëshme* (2 herë), *i nevojshëm* (2 herë), *e përgjithëshme* (përdoret vetëm 1 herë, por e gjejmë në formën *e përgjithshme* 3 herë).

Gjuha e kumtarit në këtë rregull të drejtshkrimit të sotshëm paraqet luhatje të theksuara. Mendojmë se kjo pasqyron nga njëra anë gjendjen e shqiptimit, nga ana tjetër ndërthurjen e traditave të ndryshme drejtshkrimore, toske e geqe.

ç) Del e shkruar pa **-ë**- gjymtyra e parë e trajtave të përngjitura të habitores: *paskam* (përdoret vetëm 1 herë), *paske* (vetëm 1 herë), *qenkan* (1 herë).

Nuk kemi gjetur forma si *qenëka*, *pasëka*, *ardhëka* etj. Edhe në këtë rregull të drejtshkrimit të sotëm të gjuhës shqipe kemi përkim me gjuhën e përdorur në Kumtar.

ë- ja fundore (§ 8)

Shkruhet **ë**-ja fundore te fjalët me theks që në krye të herës në rrokjen e parafundit, duke u ruajtur ajo edhe në trajtat e tyre ku s'është më fundore, p.sh.:

a) emrat femërorë: *dhjetë* (përdoret vetëm 1 herë), *fjalë* (rreth 50 herë), fjalën (1 herë), *fjalët* (përdoret 2 herë), *forcë* (përdoret 2 herë), *forcën* (përdoret 2 herë), *kâmbë* (2 herë), *këpucë* (përdoret 2 herë), *të konferencës* (2 herë), etj.

Në Kumtar përdoret në formën e gjinisë femërore emri *ligjë*, sot si mashkullor: *ligj* - *ligji*.

b) do të ishte me interes shkrimi i zanores **-ë** fundore te disa emra mashkullorë si *atë*, *burrë*, *djalë* etj. të përmendur te rregulla § 8 b e Drejtshkrimit, por në gjithë tekstin e Kumtarit nuk kemi gjetur shembuj për këtë grup emrash.

c) mbiemrat dhe ndajfoljet e tipit: *i mirë* (mbi 30 herë), *i butë* (3 herë), *vonë* (3 herë si mbiemër dhe 3 herë si ndajfolje), *e kotë* (5 herë), *kot* (4 herë si ndajfolje ndërsa *i/e kotë* si mbiemër 3 herë), *nalt* (1 herë), *e nalta* (mbi 10 herë), *i naltë* (1 herë), *e pathjeshtë* (2 herë), *plot* (3 herë si ndajfolje), *e plotë* (si mbiemër përdoret 2 herë), *i plotë* (1 herë), *të plotë* (8 herë), *shpejt* (si ndajfolje 5 herë), *i shpejtë* (si mbiemër 2 herë), *të shpejtë* (si mbiemër 7 herë), *e thjeshtë* (4 herë), *i thjeshtë* (përdoret herë), *së thjeshtë* (herë).

ç) mbiemrat e formuar me anën e prapashtesës **-të** nga emra njërrrokësh ose me theks në rrokjen fundore, si edhe nga folje që mbarojnë me zanore: *thatë* (përdoret 3 herë), *të thatë* (1 herë)

po kështu dhe numërorët rreshtorë: *të dytë* (përdoret 6 herë), *e dytë* (13 herë), *i dytë* (3 herë), *të dytët* (2 herë), *të dytën* (2 herë), *e tretë* (4 herë), *i tretë* (1 herë), *e pestë* (1 herë), *të pestën* (2 herë), *gjashtë* (2 herë), *dhjetë* (1 herë), *nëntëmbëdhjetë* (përdoret vetëm 1 herë), *njëzetë* (1 herë).

d) trajtat e shumësit të emrave dhe mbiemrave mashkullorë si: *punëtorët* (përdoret 2 herë), *studentë* (përdoret 3 herë), *veshë* (përdoret vetëm 1 herë),

Kjo **-ë** shkruhet në të gjitha rasat e shumësit, edhe kur nuk është fundore: *studentësh* (përdoret vetëm 1 herë), *studentëvet* (përdoret vetëm 1 herë),

Në emra formën e gjinor-dhanores dhe të kallëzores së emrave femërorë më - **í** të theksuar nuk është shkruar zanorja fundore **-ë**: *fuqin* (përdoret herë), *perëndis* (përdoret herë),

Vëzhgime gjuhësore mbi revistën “Kumtari arsimuer” të vitit 1921

a) Përemrat pronorë: *i, e ynë* (përdoret 8 herë), *i, e jonë* (përdoret 3 herë),
b) Numërorët themelorë: *pesë* (përdoret 6 herë), *gjashtë* (2 herë),
gjashtëmuajshin (1 herë), *tetë* (2 herë), *dhjetë* (vetëm 1 herë), *nëntëmbëdhjetë*
(vetëm 1 herë),

c) Foljet me temë më zanore, në vetën e parë dhe të tretë të shumësit të së tashmes dëftore dhe lidhore: *të mbajnë* (përdoret 1 herë), *të përmbajnë* (2 herë), *të punojmë* (vetëm 1 herë), *të punojnë* (3 herë).

d) Pjesoret e foljeve me temë më zanore a më -l, -ll, -r, -rr, dhe mbiemrat e nyjshëm të formuar prej tyre: *marrë* (përdoret 6 herë), *sjellë* (përdoret 6 herë),

Format e pjesores, p.sh. *humbë* (përdoret 2 herë), *me mundë* (përdoret 3 herë), *qenë* (përdoret 6 herë), *me thënë* (përdoret 2 herë),

Zanorja U

Shkruhen me **-u-** në të gjitha rasat emrat dhe mbiemrat më **-ull-, -ur-** si edhe fjalët e formuara prej tyre:

bukur (1 herë), *bukuri* (1 herë), *e bukur* (1 herë), *të bukur* (2 herë), *bukurshkrim* (1 herë), *fundtingull-i* (1 herë), *kryetingull-i* (1 herë), *mashkullore* (1 herë), *mestingull-i* (1 herë), *rregullore* (3 herë), *shembull* (5 herë), *shembulli* (4 herë), *tingull* (1 herë), *tingullimi* (1 herë), *i titulluem* (2 herë), *zbukurohet* (1 herë), *zbukuron* (1 herë),

Por gjejmë përveç këtyre dhe forma të tilla si: *bukër* (1 herë), *të bukër* (1 herë),

Zbatohet plotësisht rregulla e sotme e drejtshkrimit për shkrimin e **u-së**, përveç dy rasteve të mbiemrit *bukur-bukër*; *të bukur-të bukër*, të cilat nga përsëritja ndoshta mund të jenë përdorime individuale të një prej shkruësve.

Zanoret I dhe Y (§ 11)

Shkruhen me **i** dhe jo me **y** fjalët: *ai* (përdoret 31 herë), *frikë* (2 herë), *i friksuem* (1 herë), *shpirt* (2 herë), *shpirtë* (1 herë), *shpirtndrituri* (1 herë), *shpirtnore* (përdoret 1 herë), *shpirtnuer* (1 herë), *shqip* (2 herë), *shqipe* (përdoret 2 herë), *shqipja* (përdoret herë), *Shqipni* (2 herë), *shqiptar* (1 herë), *shqiptare* (1 herë), *shqiptarvet* (2 herë), *shqiptojnë* (1 herë), *shqiptohen* (1 herë), *shqiptohet* (1 herë), *shqiptuem* (2 herë),

Por krahas tyre dalin të shkruara me **y**: *të frykëshmit* (përdoret 1 herë), *Shqyptarit* (2 herë), *shqype* (1 herë), *shqyptimit* (1 herë).

Luhatja e përdorimit të **y-së** në vend të **i-së** tregon për një rregull të pangulitur mirë në gjuhën e Kumtarit.

Zanoret U dhe Y

Shkruhen me **u** dhe jo me **y** fjalët: Turqisht, turqishte,

Shkruhen me **y** dhe jo me **u**: *e natyrshme* (1 herë), *i natyrshëm* (1 herë), *natyrën* (2 herë), *natyrës* (2 herë), *virtyte* (1 herë), *virtytet* (1 herë), *virtyteve* (1 herë), *virtyti* (1 herë).

Këtu kemi një përkim të plotë me drejtshkrimin e sotëm të gjuhës shqipe.

Grupe zanoresh dhe diftongje (§ 13)

-ie/-je-

Shkruhen me **-ie**

a) Emrat tek të cilët ky grup zanoresh ndiqet nga një bashkëtingëllore e lëngët (**l, ll, r**) dhe të gjitha fjalët e formuara prej tyre: *bien* (përdoret 3 herë), *e diela* (1 herë), *dielli* (1 herë), *t'i ndiejë* (2 herë), *e ndien* (2 herë), *i ndiejnë* (1 herë), *të qiellzës* (1 herë),

Në Kumtar e gjejmë grupin **-ie-** të shkruar edhe në këto fjalë: *bursierë* (përdoret 2 herë), *t'u kthiellohet* (1 herë), *kthielltas* (1 herë), *të liehun* (1 herë), *të hieshme* (1 herë), *mbldhinie* (2 herë), *të ndiemit*, (1 herë), *e përzieme* (2 herë), *i spieguem* (1 herë), *me e spieguem* (1 herë), *me siellun* (2 herë), *të siellin* (1 herë), *shies* (1 herë), *i tërhekiekshëm* (1 herë), *zgjânie* (1 herë),

Fjalët e mëposhtme, që sipas drejtshkrimit të sotshëm shkruhen me **-je-**, te Kumtari dalin të shkruara me **-ie-**: *bursierë* (përdoret 2 herë), *diemt* (1 herë), *të hieshme* (1 herë), *t'u kthiellohet* (1 herë), *kthielltas* (1 herë), *të liehun* (1 herë), *mbldhinie* (1 herë), *të ndiemit* (1 herë), *nieri* (1 herë), *e ndieshmís* (1 herë), *e përzieme* (1 herë), *(kish) piell* (1 herë), *i spieguem* (2 herë), *me e spieguem* (2 herë), *me siellun* (1 herë), *të siellin* (1 herë), *shies* (1 herë), *i tërhekiekshëm* (1 herë), *të vieshtës* (2 herë), *të vielin* (1 herë).

Por ka dhe fjalë të shkruara me grupin **-je-** ashtu si në drejtshkrimin e sotshëm: *domethânëjen* (3 herë), *çâshtje* (9 herë), *mbledhje*, (1 herë), *të ndjeki* (1 herë), *ndjeni* (1 herë), *njerës* (2 herë), *njeri* (2 herë), *pa u përcjellun* (1 herë), *pjesë* (2 herë), *pyetjeve* (2 herë), *subjekte* (1 herë), *e skajeve* (3 herë), *stërvitje* (1 herë), *qi na shpije* (1 herë).

Grupi **ye**

Shkruhet i plotë përveç rasteve kur në kumtar gjejmë të përdorur *arësyt* (përdoret 2 herë) e cila është monoftonguar, gjithashtu dhe *i arsyshëm* (përdoret 1 herë), ndërsa në rastet e tjera ky grup shkruhet: *arsyeve* (përdoret 2 herë), *e kryeme* (2 herë), *kryesekretarit* (2 herë), *kryesis* (3 herë), *kryevijë* (2 herë), *e pakryeme* (2 herë), *i përkthym* (1 herë), *pyete* (1 herë), *pyetjeve* (1 herë).

Grupi **ua, ue**

bisedue (përdoret 2 herë), *due* (2 herë), *duem* (1 herë), *kënduem* (3 herë), *menduem* (2 herë), *muej* (2 herë), *u- mundue* (2 herë), *të përmuejshmen* (2 herë), *randuem* (1 herë), *s' uej* (2 herë), *t'uej* (7 herë),

Grupi **ue** është shkruar rregullisht, nuk kemi gjetur asnjë rast që të jetë monoftonguar. Meqenëse lënda e kumtarit është shkruar në gegërishte, mbizotëron grupi **ue**, por ka raste kur shkruhet edhe grupi **ua**: *dua* (2 herë), *duan* (vetëm 1 herë), *u caktua* (vetëm 1 herë), *e frymuar* (1 herë), *s'jam mjetuar* (1 herë), *menduar* (1 herë), *muaj* (2 herë), *muajsh* (1 herë), *t'uej përvehtësuar* (1 herë).

Mbiemra prejpjesorë

A) Pa prapashtesë

Me prapashtesën -m: *i bashkuem* (përdoret 1 herë), *të kuptueshme* (1 herë), *e laborueme* (1 herë), *e ndryshueme* (2 herë), *e pranueme* (2 herë), *e shkrueme* (1 herë), *i shkruem* (përdoret 2 herë), *i shquem* (2 herë), *të shkrueme* (1 herë),

Forma foljore

e kryer e thjeshtë: *u- dërguen* (2 herë), *u- lehtësue* (1 herë), *u- muerr* (3 herë), *u- pajue* (1 herë).

forma të pjesores: *bashkuem* (përdoret 2 herë), *caktue* (1 herë), *çue* (1 herë), *duem* (3 herë), *fillue* (1 herë), *ftue* (2 herë), *justifikue* (1 herë), *kallzue* (1 herë), *mbaruem* (2 herë), *ndërmjetsue* (1 herë), *ndryshue* (3 herë), *pandëruem* (përdoret 1 herë), *pasunuem* (1 herë), *përfaqësue* (1 herë), *përqokem* (1 herë), *pranuem* (2 herë), *qotuem* (1 herë), *sistematizue* (1 herë), *spieguem* (2 herë), *shtue* (2 herë), *tregue* (5 herë), *themeluem* (1 herë).

Emra dhe mbiemra

Me prapashtesën -or- / -uer-

Një numër emrash dhe mbiemrash të prejardhur me prapashtesën **-or**, të Kumtari paraqiten si në trajtën e pashquar me prapashtesën **-uer**, sipas tipit *qershuer-qershori*; po kështu dhe mbiemrat mashkullorë me këtë prapashtesë: *botuer* (2 herë), *të caktuemë* (1 herë), *të ftue* (1 herë), *arsimuer* (32 herë) dhe nuk gjendet në një formë tjetër.

Gjendet 12 herë në formën arsimore, por në formën mashkullore *arsimor* nuk gjendet asnjëherë. *bâtuer-ori* (gjendet vetëm 1 herë), *botuer* (përdoret 13 herë dhe gjendet vetëm në këtë formë), *cilsuer-ori* (1 herë), *drejtuer* (përdoret 3 herë dhe po ashtu nuk gjendet në asnjë formë tjetër), *dyzânuer-ori* (1 herë), *emënuer-ori* (1 herë), *emnuer* (1 herë), *filluer* (10 herë), *fjaluer* (1 herë), *foljuer* (1 herë), *gjuhuer* (3 herë), *huej* (3 herë), *lidhuer* (1 herë), *menduer* (1 herë), *mësimuer* (2 herë), *mjeshtuer* (1 herë), *ministruer* (1 herë), *numruer* (4 herë), *përshkruer-ori* (1 herë), *pronuer* (1 herë), *qershuer* (5 herë), *qytetuer* (8 herë), *shkolluer* (5 herë), *shoqënuer* (1 herë), *shpirtnuer* (1 herë), *shumuer-ori* (2 herë), *tetuer* (1 herë), *themeluer* (4 herë), *vehtuer* (1 herë),

Apostrofi

Shkruhet me apostrof përemri pyetës *ç'* dhe pjesëza mohuese *s'*: *ç'âsht* (përdoret 2 herë), *ç'dini* (1 herë), *ç'do* (2 herë), *ç'jan* (2 herë), *ç'jemi tue bâm* (1 herë), *ç'fitim* (1 herë), *ç'i mungon* (1 herë), *ç'mësohet* (2 herë), *ç'mund* (3 herë), *ç'po thue* (1 herë), *ç'probleme* (1 herë), *ç'ortografi* (1 herë), *ç'vegla* (1 herë), *ç'u bâjn* (1 herë), *ç'farë* (1 herë), *s'Arsimit* (3 herë), *s'âsht* (5 herë), *s'do të mësohet* (1 herë), *s'dijnë* (1 herë), *s'duhen bâ* (1 herë), *s'duhet* (2 herë), *s'i din* (1 herë), *s'ka të bâjë* (1 herë), *s'jam* (1 herë), *s'ka* (2 herë), *s'kanë* (1 herë), *s'kemi* (1 herë), *s'kërkon* (1 herë), *s'kishte* (2 herë), *s'mund* (6 herë), *s'pat* (1 herë), *s'përmendej* (1 herë), *s'tepron* (1 herë), *s'afërmi* (1 herë), *prej s'afërmes* (1 herë), *s'e bâjnë* (1 herë), *s'e pa* (1 herë), *s'i dij* (1 herë), *s'ndjekë* (1 herë).

Përdoret apostrofi për të shënuar rënien e zanores ë të trajtat e shkurtra **më, të**, kur pas tyre vjen një zanore: *t'i* (përdoret mbi 50 herë), *t'u* (përdoret mbi 20 herë),

Shkruhen me apostrof edhe trajtat e shkurtra: *t'a* (përdoret 8 herë), *m'a* (përdoret 1 herë),

Shkruhen me apostrof përemrat pronorë: *s'onë* (12 herë), *s'uej* (3 herë), *t'uej* (2 herë)

Përdorimi i apostrofit në tekstin e kumtarit jo gjithmonë është përkon me rregullat e sotme të drejtshkrimit. Ka raste që shënohet apostrof në vend të zanores ë të nyjave të përparme, p.sh.: *s'atjeshme* (1 herë), *s'ati* (1 herë), *s'mbramit* (1 herë), *s'parit* (1 herë), *Normales s'Elbasanit* (1 herë), *s'ushtrimit* (1 herë).

DRJTSHKRIMI I BASHKËTINGËLLOREVE

Bashkëtingëlloret e zëshme në fund e në trup të fjalës (§ 22)

Bashkëtingëlloret e zëshme **b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh**, shkruhen si të tilla, kur janë përpara një zanoreje, edhe kur gjenden në fund të fjalës ose në trup të saj përpara një bashkëtingëlloreje të shurdhët a përpara bashkëtingëllores **n**: *e fundshme* (përdoret 2 herë), *e në fund* (1 herë), *fundi* (2 herë), *fundshëm* (1 herë), *mâ së fundi* (2 herë), *këndimi* (3 herë), *të këndimit* (1 herë), *të kënduam* (1 herë), *lidhet* (2 herë), *lidhë* (2 herë), *lidhcë* (1 herë), *mbilidhini* (2 herë), *përfundim* (3 herë), *përlidhje-a* (1 herë), *përmbilidhet* (1 herë), *zgjedh* (2 herë), *e zgjedhme* (1 herë), *të zgjedhun* (1 herë).

Vihet re shurdhimi i bashkëtingëlloreve në fund të fjalës: *u- zgjoth* (përdoret 2 herë), *gjāsant* (përdoret 1 herë), *nder ment* (përdoret 1 herë), *u zdorq* (përdoret 1 herë),

SH/ ZH / Ç Nistore

Fjalët me **sh/ zh/ ç** nistore shkruhen kështu (§ 23):

a) Me **sh-**, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e shurdhët (**f, k, p, q, t, th** etj.): *shfaqet* në revistë e gjejmë dhe në formën: *çfaqet, shfaqje* (2 herë), *shfaqtim* (1 herë), *do të shkaktonte* (2 herë), *shkaqet* (2 herë), *shkoqituna* (1 herë), *shkurt* (2 herë), *të shpallë* (1 herë), *shpallun* (3 herë), *i shpejtë* (4 herë), *shpërblimin* (3 herë), *shpifen* (2 herë), *shpije* (1 herë), *me e shtuem* (2 herë), *shtjellimet* (2 herë), *tue shtjerrtuem* (1 herë),

b) Me **zh-**, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e zëshme (**b, d, g, gj, v**): *zhburruam* (përdoret 1 herë), *të zhvillueme* (përdoret 3 herë),

c) Me **ç-**, kur kjo ndiqet nga një zanore ose një bashkëtingëllore e tingullt (**l, ll, r, rr, m, n, nj, j**): *të çlirimit* (përdoret 1 herë), *çmeritë* (përdoret 1 herë),

S, Z Nistore

Fjalët me **s, z**, nistore, të ndjekur nga një bashkëtingëllore (disa prej të cilave shqiptohen ngandonjëherë edhe me **c** ose **x**), shkruhen kështu (§ 24): p.sh.:

a) Me **z-**, kur kjo ndiqet nga një bashkëtingëllore e zëshme: *zbavitjeve* (përdoret 2 herë), *zbuti* (përdoret vetëm 1 herë), *zbukuron* (përdoret 1 herë), *zgjedhje* (përdoret 3 herë)

Shkrimi i J-së (§ 25)

a) Emrat ku j-ja ndërzanore i përket temës, si edhe fjalët e formuara prej tyre: *dijení* (përdoret 1 herë), *i dijes* (përdoret 1 herë)

b) Emrat femërorë që dalin më zanore të theksuar përveç -i-së, në të gjitha trajtat, kur zanorja e theksuar ndiqet nga një zanore tjetër:

Emrat femërorë që dalim më -í të theksuar, në të gjitha trajtat kur kjo zanore ndiqet nga një zanore tjetër, dalin të shkruara me -j- ndërmjet tyre, p.sh.:

Vëzhgime gjuhësore mbi revistën “Kumtari arsimuer” të vitit 1921

gjeometrijavet (përdoret 1 herë), *gjuhësije* (1 herë), *hierarqija* (1 herë), *ministria* (6 herë), *ministrije* (4 herë), *nxehtësije* (1 herë), *orthografije* (1 herë), *shoqënjia* (1 herë), *lehtësija* (1 herë), *dobësija* (1 herë), *madhështija* (1 herë), *butësije* (2 herë), *shpejtija* (1 herë).

Kjo mënyrë shkrimi duket se pasqyron shqiptimin e kohës. Në drejtshkrimin e sotshëm është mënjeluar kjo -j- pas një -i-je të theksuar, d.m.th. shkruajmë *ministra*, *ministrie*, *nxehtësia* etj. Edhe në shqiptimin e sotshëm nuk dëgjohet ndonjë -j- në trajtat e mësipërme.

Shkrimi i H- së

Duke u mbështetur në shqiptimin letrar dhe në traditën e shkrimit, shkruhen me **h** (§ 27)

a) në fillim të fjalës: *hapat* (përdoret 2 herë), *hapësinë* (2 herë), *hapësirë* (1 herë), *u hapën* (2 herë), *hapun* (1 herë), *harmoni* (3 herë), *harta* (2 herë), *hartim* (3 herë), *hartsen* (1 herë), *hartimin* (2 herë), *të hartisunit* (2 herë), *harqe* (2 herë), *hark* (1 herë), *heshtje* (1 herë), *heshtet* (1 herë), *të hieshme* (2 herë), *hije* (1 herë), *hyjën* (2 herë), *hyjnë* (1 herë),

b) Në fund të fjalës: *u fsheh* (2 herë), *njoh* (2 herë), *përkrahu* (1 herë), *krahë*, *krahët* (3 herë),

c) Në mes të fjalës:

Trajtat pësore-vetvetore të foljeve me temë më zanore: *të përktheheshin* (përdoret 2 herë), *kthehen* (1 herë), *kthehet* (1 herë), *bëhet* (2 herë), *mësohet* (14 herë), *ndihmë* (3 herë), *ndihmës* (3 herë), *ndihmësit* (2 herë),

Fjalët me RR

Duke u mbështetur në shqiptimin shkruhen me **rr**:

a) Në fillim të fjalës:

emrat: *rradhë* (3 herë), *rranja* (2 herë), *rrasëz* (2 herë), *rrasëza* (2 herë), *rregullore* (2 herë), *rregulla* (4 herë), *rregullë* (4 herë), *rrethina* (1 herë), *rroben* (2 herë), *rrotat* (5 herë), *rrota* (2 herë), *rruzull* (4 herë), *rruzuj* (5 herë), *rruzujsh* (4 herë), *të rruzullimit* në tekst përdoret si emër në vend të *rruzullit*, *rrugën* (5 herë), *rrugë* (4 herë),

mbiemra: *i rrahun*, (përdoret herë), *të rralla* (përdoret herë), *e rrezikshme* (përdoret herë), *të rreptë* (përdoret herë), *të rregullueme* (përdoret herë),

folje: *rrafin* (përdoret herë), *rrallas* (përdoret herë), *rregullohen* (përdoret herë),

ndajfolje: *rregullisht* (përdoret herë),

b) Në mes të fjalës:

foljet: *të marrin* (përdoret 2 herë),

ndajfolja: *kurrë* (përdoret 8 herë), *kurrnji* (përdoret 3 herë), *kurrsesi* (përdoret 1 herë),

Mund të thuhet se shkrimi i bashkëtingëllores rr te Kumtari pothuajse nuk ka dallime nga rregullat e sotme. Ka luhatje për fjalë *radhë* dhe fjalët e formuara prej saj....

Kemi fjalën **rrendin** i cili në kumtar del më -rr- por që mund të jetë ndonjë gabim shtypi pasi është një rast i izoluar dhe nuk përsëritet. Mbiemri që sot në gjuhën shqipe del me rr pra **i rrëmbyeshëm** në Kumtar e gjejmë **i rëmbyshëm**.

NJ-ja në trup dhe në fund të fjalës

Shkruhen me **nj** dhe jo me **j**(§ 29):

a) Emrat femërorë me **nj** në trup të fjalës: *shkronjat* (2 herë), *shtypëshkronjë* (1 herë),

b) Mbiemrat e formuar me temë më **nj**: *të mëdhenj* (1 herë), *e zonja* (përdoret 2 herë)

Grupe bashkëtingëlloresh

MB, ND, NG, NGJ

Grupet e bashkëtingëlloreve mb, nd, ng, ngj shkruhen të plota si në fillim, ashtu dhe në trup e në fund të fjalës (§ 30):

grupi mb: *përmbajnë* (përdoret 2 herë), *mbajtun* (2 herë), *me mbajtun* (2 herë), *të mbarojë* (2 herë), *mbesim* (1 herë), *mbeshtetet* (2 herë), *mbë* (45 herë), *mbi* (35 herë), *mbushun* (2 herë), *mbushë* (2 herë), *shkëmbejnë* (2 herë), *këmbim* (1 herë), *shkëmbeim* (1 herë), *të rrëmbyeshme* (2 herë), *shëmbëllavet* (2 herë),

grupi nd: *prandaj* (përdoret 4 herë), *brenda* (2 herë), *lânda* (3 herë), *ndalohe* (1 herë), *gjinden* (2 herë), *nderin* (2 herë), *gjâsendet* (3 herë), *vendimet* (5 herë), *brenda* (2 herë), *mend* (2 herë), *sipërpërmendun* (2 herë), *vend* (4 herë), *send* (2 herë), *brendija* (2 herë), *brendis* (1 herë), *mbimendime* (1 herë), *endun* (1 herë), *vendime* (2 herë), *katundevet* (2 herë), *mund* (mbi 50 herë), *sikundër* (1 herë),

grupi ng: *ga* (përdoret mbi 100 herë), *ngarkuem* (2 herë), *ngarkoi* (2 herë), *mungesa* (8 herë), *shmanget* (2 herë), *shtrëngon* (2 herë), *i mungon* (6 herë), *ngrehni* (3 herë),

grupi ngj: *bashkangjitur* (përdoret 2 herë), *ngjan* (përdoret 1 herë), *ngjarjevet* (përdoret 3 herë), *ngjizun* (përdoret 1 herë), *e përngjitur* (përdoret 2 herë),

Shkrimi i grupeve mb, nd, ngj, bën dallimin midis dy dialekteve, pasi në toskërisht ato ruhen si të plota (me përjashtim të Labërisë), ndërsa në Gegëri okluzivi me anë të një asimilimi progresiv, u shkri brenda në nazalin homorganik që kishte përpara. Por ndryshe ndodh në revistën e Kumtarit, në të cilën shkruhen në të gjitha rastet, sipas vendimit të Komisionit Letrar. Pra ky grup nuk paraqitet i asimiluar.

Takime bashkëtingëlloresh

Takimi i T-së me SH-në

Te mbiemrat e formuar me prapashtesën **-shëm** dhe te trajtat e dëshirores, kur **sh**-ja e prapashtesës takohet me **t**-në e temës, shkruhen që të dyja këto bashkëtingëllore (pa u asimiluar në **ç**): (§ 31)p.sh.: *i mërzitshëm* (4 herë), *e ndritshme* (1 herë), *i përshtatshëm* (1 herë), *sotshme* (1 herë), *motshme* (1 herë), *dhjetshe* (1 herë), *i etshëm* (1 herë)

SHKRIMI I FJALËVE NJËSH, NDARAS DHE ME VIJË NË MES

Lidhëza që sot është e përngjitur në revistë e gjejmë: *me gjith qi* (përdoret 4 herë), *me gjitha të* (përdoret 1 herë), *megjith këtë* (2 herë), *me qenë se* (2 herë), *mirë po* lidhës kundërshtore (6 herë), *për veç se* (1 herë), *përveç se* (2 herë), *po thue* (2 herë), *po thue se* (1 herë), *po thueja* (1 herë), *sa qi* lidhës lejore (1 herë), *se sa si* lidhës krahasore është shkruar ndaras (përdoret 2 herë), *sido kudo* (2 herë), *sado qi* (përdoret bashke 3 herë, ndaras 2 here), *veç se* (5 herë),

Ndajfolje: *as pak*, (përdoret 1 herë), *drejt për se dreti* (përdoret 1 herë), *gjith kund* (2 herë), *gjithashtu* (përdoret 16 bashkë, 1 herë ndaras), *me një' anëvet* (1 herë), *nder ment* sot si ndajfolje është bashkë (1 herë), *për gjith monë* (2 herë), *vete vetiu* (2 herë), *mos pëlqimin* (1 herë)

Shkruhen ndaras parashtesat **pa-** dhe **mos-:** *i pa ndëgjueshëm* (përdoret 1 herë), *i pa mundëshmë* (1 herë), *i pa dobishmë* (1 herë), *i pa përvuejtun* (1 herë), *i pa interesuam* (1 herë), *i pa qëndrueshëm* (1 herë), *mos pëlqimin* (2 herë), *mos besimet* (1 herë), *të mos hartuemit* (1 herë).

Përfundime

- Meqenëse lënda e kumtarit është në gegërishte, janë shkruar me **a** të gjitha fjalët të cilat kjo zanore e theksuar ndiqet ose është ndjekur historikisht nga një bashkëtingëllore hundore. Me **a** shkruhen edhe të gjitha fjalët e prejardhura ose të përbëra, të formuara prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit

- Shkruhen me **e** (dhe jo me **ë**) fjalët ku kjo zanore është e theksuar dhe ndiqet ose ka qenë ndjekur në të kaluarën nga një bashkëtingëllore hundore (**m, n, nj**). Me **e** shkruhen gjithashtu fjalët e prejardhura ose të përbëra të formuara prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit.

Por në Kumtar gjejmë edhe raste kur fjalët e mësipërme ose fjalë të këtij tipi janë shkruar me **ë**, sipas shqiptimit dhe traditës së shkrimit të një pjese të madhe të toskërishtes

- Nga statistika e mësipërme mbizotërojnë format e shkruara me zanoren **-e-** në vend të zanores **-ë-**, në fjalët ku kjo zanore ndiqet nga një bashkëtingëllore hundore (**m, n, nj**). Vihet re një lëkundje në përdorimin e zanores **-e-**, herë gjenden forma me **ë** dhe herë zanorja **e** shfaqet bindshëm duke u bërë formë zotëruese. Kjo lëkundje në përdorimin e zanores **e** mund të jetë dhe një veçori e një shkruesi të një pjese të tekstit, i cili ka bartur me vete dhe veçoritë dialektore të tij.

- Në gegërishten e folur zanorja **ë** e patheksuar në këtë pozicion, është reduktuar shumë, shpesh deri në shkallën zero, p.sh. shqiptohet *dobsohet* ... etj. Te Kumtari në fjalët e këtij tipi është ndjekur mënyra e shkrimit dhe e shqiptimit e toskërishtes letrare të kohës, në pajtim edhe me "Rregullat" e Komisionit Letrar të Shkodrës. Pra drejtshkrimi i Kumtarit është në pajtim me rregullën e sotme të drejtshkrimit të shqipes.

- Disa fjalë që sipas drejtshkrimit të sotëm shkruhen pa **-ë-** në trup të tyre, në Kumtar ruhet forma e vjetër shkrimore që kanë pasur ato, p.sh.: *arësye, arësim, tregëti*.

- Me sa duket, në atë kohë -ë-ja e patheksuar ruhej ende në shqiptim në njëfarë mase dhe kjo gjendje pasqyrohet edhe në shkrimin e saj; por mund të mendohet edhe se autorët e shkrimeve janë prirë të ruajnë njësinë e morfemës prapashtesore **-shëm**, pavarësisht nga shqiptimi i saj.

- Grupi **ue** është shkruar rregullisht, nuk kemi gjetur asnjë rast që të jetë monoftonguar. Meqenëse lënda e kumtarit është shkruar në gegërishte, mbizotëron grupi **ue**, por ka raste kur shkruhet edhe grupi **ua**.

- Shkrimi i grupeve **mb, nd, ngj**, bën dallimin midis dy dialekteve, pasi në toskërisht ato ruhen si të plota (me përjashtim të Labërisë), ndërsa në Gegëri okluzivi me anë të një asimilimi progresiv, u shkri brenda në nazalin homorganik që kishte përpara. Por ndryshe ndodh në revistën e Kumtarit, në të cilën shkruhen në të gjitha rastet. Ky grup nuk paraqitet i asimiluar.

- Gjendja deri diku e stabilizuar e disa rregullave drejtshkrimore, sidomos ato për shkrimin e zanores ë të patheksuar, të grupeve të zanoreve, të grupeve të bashkëtingëlloreve tregon se drejtshkrimi i sotshëm vijon një traditë të mëparshme të shkrimit të shqipes.

- Luhatjet drejtshkrimore që kemi vënë re te “Kumtari” mendojmë se janë krejt të natyrshme për atë periudhë të lëvrimit të gjuhës shqipe. Megjithëse autorët e shkrimeve të “Kumtarit” janë ndër njerëzit më të arsimuar të kohës, ata prapëseprapë nuk kishin arritur të zotëronin tërësisht rregullat e Komisisë. Nga ana tjetër ato rregulla nuk kanë qenë të plota, pra nuk i përfshinin rastet e ndryshme që nxirrte praktika e shkrimit të gjuhës shqipe.